



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 17.6.2021

**Lënda:** Parashtrimet të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 17.6.2021, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 161, datë 18.6.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Kastriot Selita

**Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në interpretim të paragrafit të tretë të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, jurisprudenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, me qëllim verifikimin e pasurive të ligjshme, kërkon që, në mënyrë kumulative, të ekzistojnë burime të ligjshme të krijimit të të ardhurave, të cilat do të konsiderohen si të ligjshme, kur të jenë paguar detyrimet tatimore.

Në seancën e kaluar gjyqësore, të datës 31.5.2021, trupi gjykues vendosi të riçelë hetimin gjyqësor për të kërkuar informacion nga Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në rast se në zbatim të legjislacionit tatimor në fuqi taten dhe a janë tatuar të ardhurat e realizuara nga dhurimet.

Neni 155 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionon se taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të pagesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj.

Ky parim kushtetues gjen pasqyrim në legjislacionin fiskal, ndër të tjera, edhe në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

Në nenin 4, “*Burimi i të ardhurave*”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, ligjvënësi ka parashikuar burimet e të ardhurave të tatueshme, duke ndjekur parimin e listës së hapur.

Pika 1 e nenit 4, nga shkronja “a” deri në shkronjën “h” parashikon një numër të caktuar burimesh, por jo kufizuese, pasi shkronja “i” e të njëjtit nen parashikon si burim të ardhurash të tatueshme: “i) të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen”.

Po ashtu, neni 8, “*E ardhura e tatueshme*”, i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, nga shkronja “a” deri në shkronjën “h” parashikon një numër të caktuar të ardhurash të tatueshme, por jo kufizuese, pasi shkronja “g” e të njëjtit nen parashikon si të ardhura të tatueshme: “g) të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë”.

Në nenin 8/1, “*Të ardhura të përjashtuara*”, në zbatim të parimit kushtetues të sanksionuar në nenin 155 të Kushtetutës, ligjvënësi ka parashikuar një listë shteruese, të mbyllur, të të ardhurave, të cilat përjashtohen nga detyrimi i pagesës së detyrimit tatimor për të ardhurat personale. Të ardhurat e përfituara nga kontrata e dhurimit nuk rezultojnë të jenë pjesë e kësaj liste të ardhurash, që përjashtohen nga pagesa e detyrimit tatimor.

Gjithmonë referuar parimit kushtetues të sanksionuar në nenin 155 të Kushtetutës, në nenin 13/2, “*Të dhëna për të ardhurat bruto*”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ligjvënësi, në listën e të ardhurave bruto që deklarohen nga individit tatimpagues në deklaratën vjetore të të ardhurave (DIVA), referuar shkronjës “ë” të këtij neni, parashikon si të ardhura bruto të deklarueshme nga individit tatimpagues ato të realizuara si: “ë) fitimi kapital nga dhurimi”.

Në vijim të referencës në parimin kushtetues të sanksionuar në nenin 155 të Kushtetutës, bazuar në paragrafin 2, të nenit 118 të Kushtetutës dhe nenin 40 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, Ministri i Financave ka nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Në Udhëzimin nr. 5/2006, të ndryshuar, Ministri i Financave, ndër të tjera, ka përcaktuar formën dhe përmbajtjen e deklaratës individuale të të ardhurave (pika 2.8) dhe të dhënat e të ardhurave bruto, që kjo deklaratë duhet të përmbajë, referuar nenit 13/2 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

Në pikën 2.8.6 të këtij Udhëzimi, të Ministrisë së Financave, sanksionohet detyrimi i individit tatimpagues, që, për efekt të kontrollit tatimor për të ardhurat e përfituara nga fitimi kapital nëpërmjet dhurimit, duhet të paraqesë: “i) për fitimin kapital nga dhurimi, kopje të dokumenteve vërtetuese për justifikimin e origjinës së të ardhurave dhe mandatpagesës së tatimit të paguar;”.

Ndërkohë, në faqen zyrtare *web* të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve<sup>1</sup>, të aksesuar datë 16.6.2021, si informacion *open source*, në rubrikën “Individ” të kësaj faqe, në nënrubrikën “Të ardhura të tatueshme”, në zërin “Të ardhura bruto”, për efekt të zbatimit të legjislacionit tatimor, e ardhura bruto nga fitimi kapital nga dhurimi përkufizohet si vijon: *“Fitimi kapital nga dhurimi.- Dhurimi është një kontratë, me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim, palës tjetër një send të caktuar, ose një të drejtë reale, të cilat kjo i pranon”*. Sa më lart, rezulton në çështjen konkrete në gjykim.

Të vetmet të ardhura bruto që nuk deklarohen nga individit tatimpagues, janë të ardhurat e përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat personale, sipas dispozitës së nenit 8/1, “Të ardhura të përjashtuara”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar<sup>2</sup>.

Për efekt të zbatimit të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, këto dispozita të lartpërmendura të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, rezulton të kenë gjetur ndërkohë edhe interpretimin gjyqësor nga ana e këtij Kolegji, ndër të tjera, në vendimin nr.19/2019.

Për sa i takon konstatimeve mbi përmbajtjen e ligjit, dispozitave nënligjore dhe mënyrës së zbatimit të tyre, dërguar nga ana e institucioneve përkatëse<sup>3</sup>, akte të ngjashme me ato të përcjella dhe të administruara edhe gjatë hetimit administrativ të Komisionit, por që kjo trupë, referuar nenit 304 të Kodit të Procedurës Civile, vlerësoi t’i administronte kryesisht si prova të reja, Komisioneri Publik i mbetet referimit në pikat 4/1 dhe 5 të Rekomandimit të tre vëzhguesve ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit dhe përmbajtjes së bisedimeve përfundimtare, të paraqitura në këtë gjykim.

## **KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**

---

<sup>1</sup> <https://www.tatime.gov.al/c/3/11/18/te-ardhurat-bruto>

<sup>2</sup> <https://www.tatime.gov.al/c/3/11/18/te-ardhurat-bruto>.

<sup>3</sup> Shkresë nr. \*\*\*/\*\*\* prot., datë \*\*\*/6.2021, e Ministrisë së Financave dhe shkresë nr. \*\*\*/\*\*\* prot., datë \*\*\*/6.2021, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.